

E HËNA E MADHE



E HËNA E MADHE E SHENJTË

në të cilën përkujtojmë të Lumurin Josif,
të Fortbukur e të Fortmirë,
si dhe fikun e mallkuar e të tharë prej Zotit.

MËNGJESORJA

E HËNA E MADHE - Leximet biblike dhe himnet nga Shërbesa e Dhëndrit (1)

- Të dielën në mbrëmje -

UNGJILLI - Matheu 21:18-43.

Edhe në mëngjes kur u kthye në qytet, i erdhi uri. Edhe kur pa një fik në rrugë, erdhi tek ai, po nuk gjeti gjë në të, veç fletë vetëm. Edhe i thotë: Mos u bëftë më fryt prej teje për gjithë jetën. Edhe fiku menjëherë u tha. Edhe nxënësit kur panë, u çuditën, e thanë: Si u tha fiku përnjëherë?! Edhe Jisui u përgjigj e u tha atyre: Me të vërtetë po ju them juve, në paçi besim, edhe të mos jeni me dy mendje, jo vetëm këtë të fikut keni për të bërë, po dhe këtij mali në i thënçi: Ngrihu dhe bjer në det, do të bëhet. Edhe gjithë sa të kërkonin në lutje, duke besuar, do t'i merrni.

Edhe kur erdhi në tempull dhe mësonte, erdhën pranë tij kryepiftërinjtë dhe pleqtë e popullit, e thoshin: Me çfarë pushteti i bën këto? Edhe kush ta ka dhënë këtë pushtet? Edhe Jisui u përgjigj e u tha atyre: Do t'ju pyes edhe unë ju një fjalë, të cilën në ma thënçi, edhe unë do t'ju them juve me çfarë pushteti i bëj këto. Pagëzimi i Joanit nga ishte? Nga qielli apo nga njerëzit? Edhe ata mendoheshin me veten e tyre, duke thënë: Në thënçim: Nga qielli, do të na thotë: Pse nuk i besuat

pra? Edhe në thënçim: Nga njerëzit, kemi frikë prej turmës, sepse të gjithë e kanë Joanin për profet. Edhe duke iu përgjigjur Jisuit, thanë: Nuk e dimë. Edhe ai u tha atyre: As unë s'ju them juve me çfarë pushteti i bëj këto.

Edhe si ju duket juve? Një njeri kishte dy bij. Dhe erdhi tek i pari, i tha: Bir, shko sot e puno në vreshtin tim. Edhe ai u përgjigj e tha: Nuk dua. Po pastaj u pendua dhe shkoi. Edhe erdhi tek i dyti, e i tha po ashtu. Edhe ai u përgjigj e tha: Unë shkoj, zot. Edhe nuk shkoi. Cili nga këta të dy bëri dëshirën e të atit? I thonë: I pari. Jisui u thotë atyre: Me të vërtetë po ju them juve, se tagrambledhësit dhe të përdalat shkojnë më përpara se ju në mbretërinë e Perëndisë. Sepse Joani erdhi tek ju në udhë drejtësie, edhe nuk i besuat, po tagrambledhësit e të përdalat i besuan. Edhe ju, si patë, nuk u penduat pastaj, që t'i besoni.

Dëgjoni një tjetër paravoli: Një njeri ishte zot shtëpie, i cili mbolli një vresht dhe e thuri me gardh, edhe gërmoi në të një tirë, edhe ndërtoi një pìrg; edhe ua dha atë me qira bujqve e iku në vend tjetër. Edhe kur u afrua koha e të vjelave, dërgoi shërbëtorët e tij te bujqit, që të marrin frytet e tij. Edhe bujqit i zunë shërbëtorët e tij, e njërin e rrahën, e tjetrin e vranë, edhe tjetrin e vranë me gurë. Përsëri dërgoi të tjerë shërbëtorë, më tepër se të parët, por ashtu ua bënë edhe atyre. Edhe pastaj dërgoi të birin tek ata, duke thënë: Do të kenë turp nga im bir. Po bujqit kur panë të birin, i thanë njëri-tjetrit: Ky është trashëgimtari. Ejani ta vrasim dhe të përvetësojmë trashëgimin e tij. Edhe si e zunë, e nxorën jashtë vreshtit edhe e vranë. Kur të vijë i zoti i vreshtit, ç'do t'u bëjë atyre bujqve?

I thonë: Të këqijtë si mos më keq do t'i shfarosë, edhe vreshtin do t'ua japë me qira bujqve të tjerë, të cilët do t'ia japin frytet në kohët e tyre.

Jisui u thotë atyre: Kurrë s'keni lexuar në shkronjat: "Guri, që flakën tej ndërtuesit, ky u bë Kreu i qoshes; prej Zotit u bë kjo, edhe është e çuditshme në sytë tanë"? Prandaj po ju them juve, se mbretëria e Perëndisë do të merret nga ju dhe do t'i jepet një kombi që bën frytet e saj.



E HËNA E MADHE E SHENJTË

në të cilën përkujtojmë të Lumurin Josif,
të Fortbukur e të Fortmirë,
si dhe fikun e mallkuar e të tharë prej Zotit.

MËNGJESORJA

(Kryhet zakonisht të Dielën e Dafinave në mbrëmje.)

Priifti "I bekuar është Perëndia ynë...", "O Mbret qiellor..."; Lexuesi thotë Trishenjtin "Shenjt Perëndi..." (3), "Lavdi... e Tani...", "Trini e Tërë-shenjhtë...", "Mëshiro, o Zot" (3), "Lavdi... e Tani...", "Ati ynë që je në qiej..."; Priifti "Se jotja është mbretëria..."; Lexuesi Psalmet 19 dhe 20, përsëri Trishenjtin dhe Troparet "O Zot, shpëtoje popullin tënd..."; Priifti "Mëshirona, o Perëndi..."; Lexuesi Gjashëpsalmëshin, Dhjaku Paqësoret "Me paqe le t'i lutemi Zotit..." dhe Priifti Thirrjen "Se ty të përket tërë lavdia...". (Kërkoji këto përherë në fq. 288-301).

*Pastaj psalet "Alilulia" bashkë me Vargjet e tij (fq. 301) dhe Troparin e mëposhtëm.**

* Sapo fillon psalja e Troparit, Priifti del nga Dera e Veriut me ikonën e Krishtit Dhëndër dhe kryen Litaninë e Ikonës brenda kishës, i paraprirë nga llambadhet dhe temjanica. E vendos ikonën në mes të kishës. Ikona qëndron aty deri të Mërkurën e Mualhe për t'iu falur besimtarët.

Tingulli Tërthor IV

Ja se ku vjen Dhëndëri në mes të natës dhe lum shërbëtori që do ta gjejë të zgjuar dhe mjerë ai të cilin do ta gjejë mendjefjetur; shiko, pra, o shpirti im, mos mundesh prej gjumit që të mos përrjipesh te vdekja dhe të mbyllesh jashtë mbretërisë, por zgjohu duke thirrur: Shenjt, shenjt, shenjt, je, o Perëndi..., (3)

Herën e parë thuhet: "...me mbrojtjet e engjëjve, shpëtona".

Herën e dytë thuhet: "...me ndërmjetimet e shën (të kishës), shpëtona".

Herën e tretë thuhet: "...me ndërmjetimet e Hyjlindëses, mëshirona".

Pastaj thuhet Litania e Vogël "Përsëri dhe përsëri..." dhe Thirrja "Se yti është pushteti dhe jotja është mbretëria dhe fuqia dhe lavdia..." (fq. 302).

Dhe psalmen Ndenjësoret e mëposhtme.

Ndenjësoret

Tingulli I. Ton Tafon Su Sotir

Esotmja ditë nis, me shkëlqim dhe me dritë, pësimet e mëdha, për shpëtimin e botës, se Krishti për së shpejti vjen, të pësojë me mirësi, Zot' i madh që mban, në grusht të tij gjithësinë, bashkëzbrë për ne, dhe kryqëzohet mbi drurin, për ndjesën e fajeve.

E njëjtë

Me trup si na u pe, i padukur gjykatës, të vritesh vjen tani, nga ca njerëz keqbërës, dënimet na i shpëlan, me pësimet e tmerrshme; këngë dhe lavdi, dhe madhëstim të dërgojmë, të gjithë me një zë, për forcën tënde të madhe, o Zot i mëshirave.

Lavdi... e Tani...

Tingull Tërthor IV. Tin Sofian Ke Logon

Jav' e madhe e shenjtë nis me shkëlqim, me pësimet e Krishtit

plot me vajtim; ejani pra dhe priteni, dhe kremtojeni besërisht. Ja Krijuesi ja ku vjen të vuajë kryq për ne, me hetime dhe kamxhik, përpara gjykatësit; pret për ne shuplaka, dhe përqeshje prej robërisht, të gjitha po i pranon, për shpëtimin e njerëzve. Le t'i thërresim pra: o Krisht Perëndi dhe Zot, Ti dhurona ndjesën e mëkateve, që t'u falemi me besë, pësimeve të hidhura.

Më pas Dhjaku: "Dhe që të bëhemi të denjë..." (fq. 303) dhe Pifti lexon:

Ungjilli

Këndimi prej Ungjillit të Shenjtë sipas Mattheut

(21: 18-43)

Në atë kohë, në mëngjes kur u kthye Jisui në qytet, i erdhi uri. Edhe kur pa një dru fiku në rrugë, erdhi tek ai, po nuk gjeti gjë në të, vetëm fletë. Edhe i thotë: Mos u bëftë më fryt prej teje për gjithë jetën. Edhe druri i fikut menjëherë u tha. Edhe nxënësit kur panë, u çuditën, e thanë: Si u tha druri i fikut përnjëherë! Edhe Jisui u përgjigj e u tha atyre: Me të vërtetë po ju them juve, në paçi besim, dhe të mos jeni me dy mendje, jo vetëm këtë të drurit të fikut keni për të bërë, po dhe këtij mali në i thënçi: Ngrihu dhe bjer në det, do të bëhet. Edhe gjithë sa të lypni në lutjet, duke pasur besim, do t'i merrni.

Edhe kur erdhi në tempull, erdhën pranë tij atje ku mësonte, kryepërfetërinjtë dhe pleqtë e popullit, e thoshin: Me çfarë pushteti i bën këto? Dhe kush ta ka dhënë këtë pushtet? Dhe Jisui u përgjigj e u tha atyre: Do t'ju pyes edhe unë ju një fjalë, të cilën në ma thënçi, edhe unë do t'ju them juve me çfarë pushteti i bëj këto. Pagëzimi i Joanit nga ishte? Nga qielli apo nga njerëzit? Dhe ata mendoheshin me veten e tyre, duke thënë: Në thënçim: Nga qielli, do të na thotë: Pse nuk i besuat pra? Dhe në thënçim:

Nga njerëzit, kemi frikë prej turmës, sepse të gjithë e kanë Joanin për profet. Dhe iu përgjigjen Jisuit, e i thanë: Nuk e dimë. Edhe ai u tha atyre: As unë s'ju them juve me çfarë pushteti i bëj këto.

Edhe si ju duket juve? Një njeri kishte dy bij. Dhe erdhi tek i pari e i tha: Bir, shko sot e puno në vreshtin tim. Edhe ai u përgjigj e tha: Nuk dua. Po pastaj u pendua dhe shkoi. Edhe erdhi tek i dyti, e i tha po ashtu. Dhe ai u përgjigj e tha: Unë shkoj, Zot. Dhe nuk shkoi. Cili nga këta të dy bëri dëshirën e të atit? I thonë: I pari. Jisui u thotë atyre: Me të vërtetë po ju them juve, se tagrambledhësit dhe të përdalat shkojnë më përpara se ju në mbretërinë e Perëndisë. Sepse Joani erdhi tek ju në udhë drejtësie, dhe nuk i besuat, po tagrambledhësit e të përdalat i besuan. Dhe ju, si patë, nuk u penduat pastaj, që t'i besoni.

Dëgjoni një tjetër paravoli: Një njeri ishte zot shtëpie, i cili mbolli një vresht dhe e thuri me gardh, dhe gërmoi në të një sternë, dhe ndërtoi një parg; dhe ua dha atë *me qira disa* bujqve e iku në dhë të huaj. Edhe kur u afrua koha e fryteve, dërgoi shërbëtorët e tij te bujqit, që të marrin frytet e tij. Edhe bujqit i zunë shërbëtorët e tij, e njërin e rrahën, e tjetrin e vranë, dhe tjetrin e vranë me gurë. Përsëri dërgoi të tjerë shërbëtorë, më tepër se të parët, por ashtu ua bënë edhe atyre. Edhe pastaj dërgoi të birin tek ata, duke thënë: Do të kenë turp nga im bir. Po bujqit kur panë të birin, i thanë njëri-tjetrit: Ky është trashëgimtari. Ejani ta vrasim dhe të mbajmë trashëgimin e tij. Edhe si e zunë, e nxorën jashtë vreshtit dhe e vranë. Kur të vijë i zoti i vreshtit, ç'do t'u bëjë atyre bujqve?

I thonë: Keq e më keq do t'i zhdukë, dhe vreshtin do t'ua japë të tjerë bujqve, të cilët do t'ia japin frytet në kohët e tyre.

Jisui u thotë atyre: Kurrë s'keni lexuar në shkronjat: "Guri që s'e pëlqyen ata që ndërtojnë, ky u bë kreu i qoshes; nga Zoti u bë

kjo, dhe është e çuditshme në sytë tanë"! Prandaj po ju them juve, se mbretëria e Perëndisë do të merret nga ju dhe do t'i jepet një kombi që bën frytet e saj.

Psaltët: Lavdi më Ty, o Zot, lavdi më Ty.

Pastaj Lexuesi lexon Psalmën 50 (fq. 303).

Dhe menjëherë psalet:

Kanoni Triodik

Krijim i Kozma murgut. Tingulli II.

Kënga I. Irimi

Le t'i këndojmë Zotit, që thau me urdhrin e tij të perëndishëm detin e trazuar të pakalueshëm dhe udhëhoqi nëpër të më këmbë popullin izraelit, se u lavdërua lavdërisht.

Troparet

Lavdi më Ty, o Perëndia ynë, lavdi më Ty.

Zbritja mistike e Fjalës Perëndi, që është Krishti vetë, Perëndi edhe njeri, u dëftën nxënësve, që duke marrë formë robi, s' kujtoi se qe rrëmbim të jetë dhe Perëndi, se u lavdërua lavdërisht.

Lavdi... e Tani...

Kam ardhur t'i shërbej vetë, unë Gatuesi, i pasuri nga Hyjnia, Adamit të varfëruar, me formën e të cilit jam veshur duke dashur, e të vë shpirtin tim si shpërblim të tij, unë i papësuari nga Hyjnia.

Zbritësorja

Le t'i këndojmë Zotit...

Pastaj thuhet Litania e Vogël "Përsëri dhe përsëri..." dhe Thirrja "Se Ti je mbret i paqes dhe shpëtimtar i shpirtrave tanë dhe Ty ta drejtojmë lavdinë..." (fq.305).

Dhe Lexuesi lexon:

Shkurtorja

Tingulli Tërthor IV. Os Aparhas Tis Fiseos

Jakovi vajtonte për humbjen e Josifit, edhe trimi rrinte në qerre i nderuar si mbret, se duke mos u robëruar atëherë nga epshet e egjiptianes, lavdërohej prej Atij që sheh zemrat e njerëzve dhe fal kurorë.

Shtëpia

Aftos Monos Iparhis Athanatos

Vajtimit le t'i shtojmë tani vajtim, duke qarë bashkë me Jakovin për Josifin e lumur e të përkorshëm, që u robërua nga trupi, por që e mbajti shpirtin të parobëruar dhe zotëroi mbi tërë Egjiptin, se Perëndia u fal shërbëtorëve të tij kurorë të pafishkur.

Sinaksari

Lexohet Sinaksari i Mujores, pastaj kjo:

Të Hënën e Madhe e të Shenjtë përkujtojmë të Lumurin Josif të Fortbukur e Fortmirë dhe fikun që u mallkua dhe u tha prej Zotit.

Vargje

Për Josifin e Fortmirë

Josifi i urtë u tregua sundues i drejtë dhe ndarës i drejtë i drithit.

Për tharjen e fikut

Sinagoga e judenjve ishte për Krishtin si një pemë fiku e zhveshur nga frytet shpirtërore që ai e thau me mallkimin e tij. Le të largohemi nga një pësim i tillë!

Me ndërmjetimet e Josifit të Fortmirë, o Krisht Perëndi, mëshirona. Amin.

Kënga VIII. Irimi

U drodh trupi i kulluar i djemve të lumur, i njëstolisshëm me shpirtin dhe largoi zjarrin e palodhur të ushqyer me një lëndë të amëshuar dhe prej plagës së fishkur këndohej një himn përjetësor i të gjallit-gjithmonë: Zotin himnoni, gjithë ju veprat e tij dhe e përmbilartësoni në gjithë jetët.

Troparet

Lavdi më Ty, o Perëndia ynë, lavdi më Ty.

Atëherë do t'ju njohin të gjithë për nxënës të mi, po të ruani porosinë e mia, u thoshte miqve Shpëtimtari, kur vinte te pësimet. Kini paqe me veten tuaj dhe me të gjithë, duke u menduar përlulesisht, lartësohuni, dhe duke më njohur për Zot, më himnoni e më përmbilartësoni në gjithë jetët.

Bekojmë Atin e Birin dhe Shpirtin e Shenjtë, Zotin.

Tani e përherë e në jetë të jetëve. Amin.

Pushteti juaj në mes të bashkëkombësve të jetë e kundërta e urdhërit të kombeve, se mizoria arbitrare s'është pjesa ime. Ai pra që do të jetë i pari ndër ju, le të jetë më i fundit i të gjithëve, dhe duke më njohur për Zot, më himnoni e më përmbilartësoni në gjithë jetët.

Himnojmë, bekojmë dhe i falemë Zotit.

Zbritësorja

U drodh trupi i kulluar...

Dhjakë: Hyjlindësen dhe Mëmën e Dritës, duke nderuar me himne, le ta madhërojmë.

Kënga IX. Irimi

E madhështove, o Krisht, Hyjlindësen që të lindi, prej së cilës Ti, Gatuesi ynë, u mbështolle me trupin bashkëvuajtës, zgjidhjen e mëkateve tona, duke e lumëruar, gjithë brezat Ty të madhështojnë.

Troparet

Lavdi më Ty, o Perëndia ynë, lavdi më Ty.

Duke shtyrë tej çdo ndyrësi, merrni prapë mendje të mençur të vyer për mbretërinë e perëndishme, u parathe apostujve të tu Ti, urtësi e të gjithëve, në të cilën do të lavdërohemi, duke shkëlqyer më larg se dielli.

Lavdi... e Tani...

Duke pasur syrin tek unë, u the nxënësve të tu, o Zot, mos kryelartoni, por shoqërohuni me të përlulurit; do të pini kupën që pi unë, se do të lavdëroheni me mua te mbretëria e tim Eti.

Zbritësorja

E madhështove, o Krisht...

Pastaj thuhet Litania e Vogël "Përsëri dhe përsëri..." dhe Thirrja "Se Ty të lavdërojnë tërë fuqitë e qiejve dhe Ty ta drejtojnë lavdinë..." (fq. 305).

Dërgimësorja

Tingulli III. I Njëmëlodishëm

Nusëroren tënde shoh, o Shpëtimtari im të stolisur, edhe rrobë nuk kam që të hyj brenda në të; ndriçoma pra stolinë e shpirtit, Dritëdhënës dhe shpëtomë. (3)

Psalmi Lavdërimet (Vargjet në fq. 305-306) me Vargëzimet e Vetëmëlodishme.

Lavdërimet

Çdo frymë le të lavdërojë Zotin. Lavdërojeni Zotin prej qiejve, lavdërojeni në më të lartat. Ty të ka hije himni, o Perëndi.

Lavdërojeni gjithë engjëjt e tij, lavdërojeni gjithë fuqitë e tij. Ty të ka hije himni, o Perëndi.

Vargu: Lavdërojeni për fuqitë e tij...

I Kozma murgut. Tingulli I. I Vetëmelodishëm

Kur vinte Zoti te pësimi vullnetar, u thoshte apostujve gjatë udhës: Ja ku po ngjitemi në Jerusalem dhe i Bir i njeriut do të përjipet, siç është shkruar për të. Ejani pra dhe ne, me mendje të pastruara, të shkojmë e të kryqëzohemi me të dhe të bëhemi për të si të vdekur për dëfrimet e jetës, që të rrojmë me të e ta dëgjojmë të thërresë: Nuk shkoj më në Jerusalem të përmbidheshëm për të pësuar, por ngjitem tek Ati im dhe Ati juaj dhe Perëndia im dhe Perëndia juaj, dhe do t'ju ngjit bashkë te Jerusalem i sipërm, te mbretëri e qiejve.

Vargu: Lavdërojeni me zë trumbete...

Kur vinte Zoti te pësimi vullnetar...

Vargu: Lavdërojeni me timpan dhe valle...

I të njëjtit. Tingulli Tërthor I

Si arritëm, o besnikë, pësimin shpëtimtar të Krishtit Perëndisë, le të lavdërojmë zemërgjerësinë e tij të patreguar, që nëpërmjet dhembshurisë së tij të na ngrejë bashkë dhe ne të vdekurit prej mëkatit, si i mirë dhe njeridashës.

Vargu: Lavdërojeni me cimbale tingëlluese...

Si arritëm, o besnikë...

Lavdi... e Tani...

I të njëjtit. Tingulli Tërthor I

O Zot, kur vije te pësimi, duke mbështetur nxënësit e tu, u thoje si i more mënjane: Si nuk i mbani mend fjalët e mia, që jua thashë prej kohe, se është shkruar që çdo profet nuk do të vritet, veçse në Jerusalem? Tani, pra, ka ardhur koha që ju thashë, se ja ku përijpem në duar mëkatarësh që të përqeshem, të cilët, pasi të më mbërthejnë në kryq e të më varrosin, do të më numërojnë si të vdekur të urreyer, por kini kurajë, se pas tri ditësh do të ngjallet, për ngazëllim të besnikëve dhe për jetë të amëshuar.

Lexuesi lexon Dhokologjinë e Vögël "Ty të ka hije lavdi..." (fq. 307).

Pastaj thuhet Plotësoret "Le ta plotësojmë lutjen tonë të mëngjesit..." dhe Thirrja "Se Ti je Perëndi mëshire, dhembshurimesh..." "Paqe të gjithëve", "Kryet tanë...", Urata e Uljes së Kryeve dhe Thirrja "Se Ti e ke në dorë të na mëshirosh..." (fq. 310).

Dhe menjëherë psalen Pasvargjet me Vargjet (fq. 310-311).

Pasvargjet

I Kozma murgut. Tingulli Tërthor I

O Zot, nëna e Zebedejeve, duke mos mundur të kuptojë misterin e patreguar të ekonomisë sate, të kërkonte t'u dhuroje bijve të saj nder prej një mbretërie të përkohshme; por Ti, në vend të këtij, u zotove ndër miqtë e tu të pinë kupë vdekjeje, të cilën thoje se do ta pije vetë para tyre, si spastrim mëkatesh; prandaj të thërresim: O shpëtimi i shpirtrave tanë, lavdi më Ty.

Vargu: U mbushëm në mëngjes me përdëllimin tënd, o Zot...

I të njëjtit. Tingulli i njëjtë

O Zot, duke mësuar nxënësit e tu të mendohen me të përsosurat, u thoje të mos u shëmbëllejné kombeve me të sunduar të vegjlit, se nuk do të jetë ashtu për nxënësit e mi, se unë dua e jam i varfër; i pari pra i juaj, le të jetë shërbëtori i të gjithëve, edhe kreu si vartësi, edhe i zgjedhuri për i parë si i fundit; se unë vetë erdha t'i shërbej Adamit të varfëruar dhe të jap shpirtin si shpërblim për të shumtët që më thërresin: Lavdi më Ty.

Vargu: Dhe shkëlqimi i Zotit, Perëndisë tonë, qoftë mbi ne...

I të njëjtit. Tingulli Tërthor IV

Duke pasur frikë nga mallkimi i fikut që u tha nga pafrytësia, o vëllezër, le t'i biem fryte të vyera pendimi Krishtit që fal përdëllimin e madh.

Lavdi... e Tani...

I të njëjtit. Tingulli i njëjtë

Dragoi, duke gjetur gruan egjiptiane si Evë të dytë, nxitonte të përmbyste Josifin me fjalë lajke, por ai, duke lënë rrobën, iku nga mëkati dhe nuk i vinte për turp që ishte i zhveshur, si Adami përpara mosdëgjimit; me lutjet e tij, o Krisht, mëshirona.

Prifti "Është mirë të lavdërojmë Zotin..." (fq. 311); *Lexuesi Trishenjtin* "Shenjt Perëndi..." (3), "Lavdi... e Tani...", "Trini e Tërshenjtë...", "Mëshiro, o Zot" (3), "Lavdi... e Tani...", "Ati ynë që je në qiej..."; *Prifti* "Se jotja është mbretëria...".

Lexuesi Shkurtoren "Jakovi vajtonte për humbjen e Josifit..." (fq. 14), "Mëshiro, o Zot" (12), "Lavdi... e Tani...", "Më të nderuarën...", "Beko, o Atë, në emrin e Zotit"; *Prifti* "Krishti Perëndia ynë që është i bekuar...", "O Mbret qiellor, forcoji...", *Urata e oshënar Efrem Sirianit* (fq. 312).

Dhe kryhet Përlëshimi (fq. 312-313):

Prifti "Lavdi më Ty, o Krisht..."; *Lexuesi* "Lavdi... e Tani...", "Mëshiro, o Zot" (3), "Beko, o Atë i shenjtë".

Prifti: Duke ardhur Zoti te pësimi vullnetar për shpëtimin tonë, Krishti Perëndia ynë i vërtetë..., "Me uratat...".

Psaltët: Amin.



[Kisha Orthodhokse Autoqefale e Shqipërisë](#)